



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**RREGULLORE**

**PËR**

**PROCEDURAT DHE MËNYRËN E DEPOZITIMIT TË INFORMACIONIT DHE  
DOKUMENTACIONIT NË LIDHJE ME BURIMIN E KAPITALIT PËR  
AKSIONARËT E SHOQËRISË SË SIGURIMIT**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr.1, datë 25.01.2016  
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 125, datë 21.06.2019  
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 119, datë 25.07.2025*

**Neni 1  
Objekti**

Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e dokumentacionit për aksionarët themelues të shoqërisë së sigurimit, procedurat dhe mënyrat e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit, si dhe mënyrën e vlerësimit të përmbushjes së kriterëve nga aksionari influencues.

**Neni 2  
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 14, të ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, si dhe të pikës 5, të nenit 16 dhe paragrafit III të nenit 30 të ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

**Neni 3  
Dokumentacioni për aksionarin themelues**

1. Çdo aksionar themelues i shoqërisë, që ka paraqitur kërkesën për ushtrim veprimtarie në sigurime, depoziton si pjesë të dokumentacionit të plotë për licencim, dokumentacionin si më poshtë:

a. Për aksionarin person fizik:

- i. CV dhe kopje të dokumentit të identifikimit;
- ii. Deklaratë nëse zotëron aksione/kuotave në shoqëri të tjera;
- iii. Deklaratë për pjesëmarrjen/t e tij në këshillin e administrimit/mbikëqyrës ose qënien administrator ose anëtar bordi në ndonjë shoqëri tjetër;
- iv. Dokument që vërteton se nuk ka detyrime fiskale të papaguara në afat, të lëshuar nga administrata tatimore;
- v. Vërtetim nga Regjistri i Kredive pranë Bankës së Shqipërisë, për gjendjen e kredive në sistemin bankar;
- vi. Dokument i lëshuar nga organet kompetente, që vërteton se personi:
  - i. Nuk është në ndjekje penale;
  - ii. Nuk është në gjykim për vepra penale;
  - iii. Nuk ka qenë ndonjëherë i dënuar penalisht;
  - iv. Nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera. Në rast se aksionari është person i huaj, dokument mbi të dhënat kriminale të lëshuara nga organi kompetent i vendit të huaj.
- vii. Deklaratë personale se nuk ka qenë ortak/aksionar i një shoqërie, për të cilën janë hapur procedurat e falimentimit apo të vendosur në likuidim;
- viii. Deklaratë personale se nuk i është hequr ndonjëherë e drejta për të ushtruar një veprimtari të caktuar tregtare brenda apo jashtë vendit;
- ix. Deklaratë personale për mosdhënie kontributi apo ndihme në themelimin e veprimtarive të paautorizuara tregtare të pranimit dhe të grumbullimit të depozitave.

b. Për aksionarin person juridik:

- i. Dokument i regjistrimit në regjistrin tregtar si person juridik dhe statutin e shoqërisë;
- ii. Vendim i organit të personit juridik për t'u bërë aksionar themelues në shoqërinë e sigurimit;
- iii. Deklaratë për pozicionin e personit juridik në grupin e shoqërive ku bën pjesë, të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i tij (nëse është e aplikueshme);
- iv. Strukturën e kapitalit të personit juridik, deri në aksionarin e fundit përfitues;
- v. Deklaratë për pjesëmarrjet e aksionarit themelues jo më pak se 10 (dhjetë) përqind të të drejtave të votës në shoqëritë që zotëron, të shoqëruar me një përmbledhje të veprimtarisë/ve që këto të fundit kryejnë, (në qoftë se është e aplikueshme);
- vi. Pasqyrat financiare të audituara të 3-viteve të fundit, që tregojnë se natyra dhe burimet financiare të personit juridik janë të tilla që mund të sigurojnë mbështetje me kapital shtesë të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit si dhe evidencën e mjaftueshmërisë së mjeteve monetare në arkë dhe në banka, për pagimin e kapitalit,

- dhe për personin juridik me më pak se 3 vjet aktivitet, pasqyrat financiare për të gjitha vitet e aktivitetit;
- vii. Dokument që vërteton se nuk ka detyrime fiskale të papaguara në afat, të lëshuar nga administrata tatimore;
  - viii. Vërtetim nga Regjistri i Kredive pranë Bankës së Shqipërisë, për gjendjen e kredive në sistemin bankar;
  - ix. Deklaratë noteriale për shlyerjen e rregullt të detyrimeve ndaj të tretëve;
  - x. Dokument i lëshuar nga organet kompetente se subjekti:
    - i. Nuk është në ndjekje penale;
    - ii. Nuk është në gjykim për vepra penale;
    - iii. Nuk është i dënuar penalisht;
    - iv. Nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera dhe se;
    - v. Ndaj tij nuk kanë filluar procedura të paaftësisë paguese, të falimentimit ose të likuidimit.
2. Në rastin kur aksionari themelues, person juridik, ka selinë qendrore në një vend tjetër, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dokument mbi të dhënat kriminale të lëshuara nga organi kompetent i vendit të huaj si dhe konfirmim nga rregullatori përkatës se personi juridik (institucion financiar) ka gjendje financiare të mirë në juridiksionin ku vepron.
  3. Dokumentacioni i parashikuar në pikën 1 të këtij neni plotësohet edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote.
  4. Çdo vit brenda muajit janar shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet çdo ndryshim të aksionarit të fundit përfitues.
  5. Shoqëritë e sigurimit kanë detyrimin të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga individët që mbajnë pozicionet përkatëse. Vlerësimi i këtyre kriterëve duhet të kryhet rregullisht, të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mund të ndikojnë në profilin e individit. Shoqëritë e sigurimit depozitojnë në Autoritet çdo vit, brenda muajit mars të vitit pasardhës vetëdeklarimet përkatëse të çdo individi mbi vijueshmërinë e përmbushjes së kriterëve.

#### **Neni 4**

#### **Informacioni shtesë për burimin e kapitalit**

1. Përveç sa është parashikuar në nenin 3, të kësaj rregullore aksionari themelues depoziton informacionin dhe dokumentacion si më poshtë:
  - a. Për personin fizik:
    - i. Informacion mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, të akumuluar ndërmjet viteve deri në momentin e aplikimit si aksionar themelues i shoqërisë së sigurimit që janë

- në pronësi të tij, ose bashkëpronësi, sipas Aneksit 1, Formulari 1, të kësaj rregulloreje;
- ii. Informacion mbi të ardhurat e krijuara gjatë tre viteve të fundit, duke përshtatur emrin e institucionit, shoqërisë apo aktivitetin ku janë siguruar të ardhurat, sipas Aneksit 1, Formulari 2 të kësaj rregulloreje;
  - iii. Informacion mbi detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e aplikimit si aksionar themelues, sipas Aneksit 1, Formulari 3 të kësaj rregulloreje;
  - iv. Deklaratën noteriale mbi vërtetësinë e informacionit sipas deklaratës-tip të paraqitur në Aneksin 2 të kësaj rregulloreje;
  - v. Dokumenti bankar që vërteton derdhjen e kapitalit;
  - vi. Dokumentacioni që vërteton burimin për pjesën e parave të derdhur në kapitalin e shoqërisë së sigurimit.
- b. Për personin juridik:
- i. Deklaratë e organit të personit juridik për burimin e kapitalit për themelimin e shoqërisë së sigurimit;
  - ii. Dokumenti bankar që vërteton derdhjen e kapitalit.
2. Autoriteti ka të drejtë të marrë informacion në lidhje me sa është deklaruar nga aksionari themelues mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga ky i fundit, sipas autorizimit tip të paraqitur në Aneksin 3 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 5**

### **Kriteret për të qenë aksionar influencues**

1. Aksionari, i cilësuar si aksionar influencues sipas nenit 48, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” zbaton kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore.
2. Autoriteti vlerëson nëse aksionari influencues, është i përshtatshëm për të mbajtur pozicionin e tij, në qoftë se ai:
  - a. Nuk ka detyrimeve fiskale të papaguara në afat;
  - b. Nuk ka kredi të klasifikuara si “kredi të këqija”;
  - c. Nuk ka qenë ortak/aksionar i një shoqërie, për të cilën janë hapur procedurat e falimentimit apo të vendosur në likuidim.
  - d. Dokument i lëshuar nga organet kompetente se personi:
    - i. Nuk është në ndjekje penale;
    - ii. Nuk është në gjykim për vepra penale;
    - iii. Nuk është i dënuar penalisht;
    - iv. Nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera;

- v. Nuk është në procedura të paaftësisë pague, të falimentimit ose të likuidimit (kur është e aplikueshme).
  - e. Nuk i është hequr e drejta për të ushtruar një veprimtari të caktuar tregtare brenda apo jashtë vendit;
  - f. Nuk ka dhënë kontribut apo ndihmë në themelimin e veprimtarive të paaautorizuara tregtare të pranimit dhe të grumbullimit të depozitave;
  - g. Dokumentacioni i paraqitur justifikon burimin e kapitalit në shoqërinë e sigurimit;
  - h. Ka gjendje financiare të shëndetshme, i vlerësuar mbi bazën e dokumentacionit të depozituar.
3. Në rastin kur, subjekti i cili kërkon të zotërojë pjesëmarrje influencuese është person juridik përveç sa parashikohet në këtë nen, duhet të depozitojë edhe:
- a. Vlerësim pozitiv të autoritetit mbikëqyrës të vendit të origjinës, kur personi që kërkon zotërimin ose ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë është një shoqëri sigurimi ose institucion financiar i huaj i licencuar.
  - b. Planin e biznesit, në rastet kur pjesëmarrjes influencuese tejkalon nivelin 30 ose 50 për qind të kapitalit të shoqërisë së sigurimit ose të të drejtave të votës.

## **Neni 6**

### **Forma e dokumentacionit**

1. Dokumentacioni i listuar në këtë rregullore është i vlefshëm si për aksionarin shtetas shqiptar apo person juridik i regjistruar në territorin e Shqipërisë, ashtu edhe për aksionarin person i huaj.
2. Të gjithë deklaratat dhe kopjet e dokumentave të kërkuara duhet të jenë në gjuhën origjinale sipas vendit ku janë lëshuar. Dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe dhe vërtetimi nga institucionet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokumentacioni duhet të jetë jo më i hershëm se i tre muajve të fundit nga dorëzimi i kërkesës me përjashtim të raporteve financiare.
4. Aksionari, subjekt i kësaj rregullore, është përgjegjës për vërtetësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dorëzuar.

## **Neni 7**

### **Procedura dhe mënyrat e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit**

1. Dokumentacioni për aksionarët themelues të shoqërisë së sigurimit, sipas nenit 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje depozitohet në Autoritet së bashku me kërkesën për martjen e miratimit paraprak për ushtrim veprimtarie në sigurime.

2. Dokumentacioni për aksionarin influencues të shoqërisë së sigurimit, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje depozitohet në Autoritet së bashku me kërkesën për miratimin e pjesëmarrjes influencuese në shoqërinë e sigurimit.
3. Kur Autoriteti vëren mangësi në dokumentacionin e paraqitur apo e gjykon të nevojshme, i kërkon shoqërisë së sigurimit plotësim dokumentacioni dhe informacion shtesë brenda një afati, i cili nuk mund të jetë më shumë se 1 muaj.
4. Dokumentacioni i mësipërm shqyrtohet si pjesë e dokumentacionit dhe informacionit të depozituar për marrjen e miratimit paraprak për ushtrim veprimtarie në sigurime.
5. Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit të aksionarëve, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.

### **Neni 7/1**

#### **Bashkëpunimi me DPPP**

1. Në rast se Autoriteti konstaton, apo ka dyshime të arsyeshme se aksionari themelues, aksionari influencues dhe/apo burimi i parave të tij lidhet me persona të dënuar për kryerjen e veprave penale, që kanë lidhje familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi me aksionarët e propozuar, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe pezullon procedurën e licencimit apo miratimit deri në një përgjigje nga kjo e fundit.
2. Në rast se Autoriteti konstaton, apo ka dyshime të arsyeshme se struktura e kapitalit të shoqërisë së sigurimit apo burimi i tij lidhet me kompani të regjistruara në parajsa fiskale, njofton dhe kërkon informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe pezullon procedurën e licencimit apo miratimit deri në një përgjigje nga kjo e fundit.

### **Neni 8**

#### **Rritja e kapitalit**

Dokumentacioni, procedura si dhe rregullat e parashikuara në nenet e kësaj rregulloreje zbatohen për çdo rritje të kapitalit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.

### **Neni 9**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

## ANEKSI 1

Formulari 1  
(për aksionarin – person fizik)

### TË DHËNA MBI PASURINË

*Përshkruani hollësisht pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, duke treguar vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë, adresën, pjesën që zotëroni.*

Nr.	Përshkrimi i pasurisë	Vlera në lekë ose në valutë të huaj	Viti i krijimit	Pjesa në %

Në këtë formular shënohen:

- a. Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b. Pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c. Sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 lekë**;
- ç. Vlera e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d. Vlera e likuiditeteve: në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, si dhe gjendje në **Cash** jashtë sistemit bankar, në lekë ose në valutë të huaj.

---

**Emër, Mbiemër, Firmë**

**TË ARDHURA TË KRIJUARA GJATË TRE VITEVE TË FUNDIT**

*Përshkruani hollësisht çdo lloj të ardhure, të krijuar gjatë tre viteve të fundit, duke përshkruar emrin e institucionit, shoqërisë apo aktivitetin ku janë siguruar të ardhurat.*

<b>Përshkrimi i të ardhurave</b>	<b>Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë Viti ..</b>	<b>Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë Viti ..</b>	<b>Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë Viti ..</b>

---

Emër, Mbiemër, Firma

**DETYRIMET FINANCIARE  
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

*Përshkruani hollësisht të gjitha detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e aplikimit si aksionar themelues i shoqërisë së sigurimit, përveç kredive në sistemin bankar shqiptar, që pasqyrohen në vërtetimin e lëshuar nga Regjistri i kredive.*

<b>Përshkrimi i detyrimeve</b>	<b>Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer</b>

\_\_\_\_\_  
Emri, Mbiemri, Firma

**ANEKSI 2**  
**(për aksionarin – person fizik)**

**DEKLARATË**  
**NOTERIALE**

Nëpërmjet kësaj deklarate vërtetoj se informacioni i paraqitur këtu është i vërtetë dhe i saktë, ai pasqyron të gjitha pasuritë dhe detyrimet dhe nuk përmban fshehje të fakteve. Vërtetoj se informacioni i dhënë i paraqitet vullnetarisht nga unë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në Aneksin 1, 2 dhe 3 bashkangjitur kësaj deklarate mund të jetë shkak që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të refuzojë pjesëmarrjen time si aksionar në shoqërinë e sigurimit \_\_\_\_\_.

Në qoftë se kërkohet informacion financiar shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

\_\_\_\_\_  
( Data )

\_\_\_\_\_  
( nënshkrimi i plotë)

ADRESA: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
( Nënshkrimi i noterit)

**ANEKSI 3**  
**(për aksionarin – person fizik)**

**AUTORIZIM PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT**  
**KONFIDENCIAL**

ATIJ QË MUND TI INTERESOJË:

Unë, \_\_\_\_\_, autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate, shoqërie apo institucioni, të cilët kanë kontroll mbi çdo lloj dokumenti, regjistri apo informacioni tjetër që ka të bëjë me mua dhe të paraqitur në Autoritet për të gjitha pasuritë dhe detyrimet e mia, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti, regjistri apo informacioni tjetër Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare apo ndonjë personi të autorizuar prej tij për qëllime të inspektimit ose kopjimit të tyre në zbatim të legjislacionit shqiptar.

\_\_\_\_\_  
Emri Mbiemri

\_\_\_\_\_  
Adresa e plotë

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
(Data)

Nënshkruar në praninë time,  
\_\_\_\_\_ data \_\_\_\_\_ 20 \_\_\_\_\_

**KY DOKUMENT ËSHTË I VLEFSHËM PËR 6 MUAJ**

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi i noterit)